

VENDIM
Nr. 116, datë 27.2.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 966, DATË 2.12.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE
DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE
STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT
EVROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË
PARAANËTARËSIMIT IPARD II (2014–2020), SEKTORI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11 të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e vendimit nr. 966, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës menaxhuese

Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPARD II, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualët e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përgjegjëse për financat.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama